

E nderuar Znj. Ministre Harito,

E nderuar Znj. Asistente e Administratorit të USAID-it për Zyrën e Evropës dhe Euroazisë, Alexander,

Të nderuar pjesëmarrës,

Më lejoni t'Ju uroj mirseardhjen dhe t'Ju falenderoj për prezencën në këtë event, të organizuar për dorëzimin e paketave portabel të inspektimit nga USAID për Inspektoratin Qendror, projekt i financuar në mbështetje të Reformës të Inspektiveve, pjesë e Reformës Rregullatore në kuadër të së cilës u krijuan gjithashtu Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Qendra Kombëtare e Licencimit, edhe këto institucione të mbështetura nga USAID, si pjesë e asistencës së Millennium Challenge Corporation.

Kjo reformë u iniciua nga Qeveria Shqiptare me qëllim uljen e barrës administrative ndaj biznesit dhe rritjen e efikasitetit të inspektiveve.

Hapat e para të kësaj reforme ishin miratimi i Ligjit kuadër për Inspektimin dhe krijimi i Inspektoratit Qendror, institucion që ka për qëllim udhëheqjen, kordinimin dhe monitorimin e zbatimit të elementeve përbërëse të reformës si, unifikimi dhe standartizimi i procedurave të inspektimit, riorganizimi institucional i trupave inspektuese sipas parimit një inspektorat/ ministri, digjitalizimin dhe modernizimin e inspektiveve nëpërmjet krijimit të portalit unik *e-Inspektimi*, krijimin e regjistrit aktiv të inspektorëve shtetërorë, që së bashku me të

drejtat dhe detyrimet e reja me të cilat i ngarkon Ligji për Inspektimin i japin atyre një status të rinovuar.

Kjo reformë erdhi si domosdoshmëri e kohës dhe kërkesë e palëve të interesit, bizneseve dhe konsumatorëve, duke u bazuar në standartet dhe praktikat me të mira të vendeve të Bashkimit Evropian dhe vendeve të tjera përfundimtare, të cilat kanë iniciuar edhe ato reforma të tilla rregullatore.

Në pikënisje , projektit BERIS i Bankës Botërore konstatonte se në Shqipëri rregullat ishin komplekse dhe të shumta, frekuenca e inspektimeve ndaj bizneseve ishte e madhe, inspektimet bëheshin pa programim të saktë, pa objektiva të qarta, si dhe pa njoftim paraprak, duke bërë që subjektet të humbisnin mesatarisht 45 ditë pune në vit si rezultat i inspektimeve.

Kishte mungesë informacioni dhe këshillimi të trupave të inspektimit, si ndaj subjekteve, ashtu edhe ndaj shtetasve, duke marrë masa administrative dhe sanksione shpesh in-efektive dhe jo-parandaluese.

Sipas te njëjtit projekt, në vitin 2008 rezultonin rreth 33 trupa të fragmentarizuara inspektuese ne nivel ekzekutivi, me mungesë kooperimi dhe koordinimi ndërmjet tyre.

Pra nevojitej një ndryshim, një reformë e thellë për të ulur barrën ndaj biznesit, për të rritur efikasitetin e trupave inspektuese në funksion të mbrojtjes së interesit publik. Nevojitej një reformë, e cila te krijonte premisat për një dinamikë të bashkëveprimit midis inspektorateve, bizneseve dhe shtetasve,

duke përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe mekanizmat e koordimit dhe të monitorimit të tyre, duke ndryshuar kulturën e inspektimeve, nga ajo ndëshkuese në atë këshilluese dhe parandaluese.

Tashmë janë finalizuar shumë nga elementet e kësaj reforma, është amenduar gjithë kuadri ligjor mbi inspektimet, janë miratuar vendimet e KM për krijimin dhe organizimin e inspektorateve shtetërore, ndër to edhe për tre inspektoratet pilot të ftuara në këtë event, janë miratuar një sërë aktesh të tjera që vinë si detyrim i Ligjit për Inspektimet dhe është krijuar portali *e-Inspektimi*.

Këto elemente do të lejojnë rritjen e transparencës dhe profesionalizmit të trupave inspektuese, të koordimit ndërmjet tyre si dhe të programimit të inspektimeve mbi objektiva të qarta dhe bazuar mbi riskun që prodhojnë bizneset për interesin publik.

Elemente të tjera janë në fazën e finalizimit çka do të thotë që kjo reforme vazhdon.

Një ndër këto është edhe ky projekt për pajisjen e inspektorëve shtetërorë me paketa portabël inspektimi, që kanë në përbërje një laptop, një skaner, një printer portabël dhe një lidhje interneti nëpërmjet një USB.

Kjo paketë është thelbësore për aksesimin në portal dhe kryerjen e inspektimeve në kohë reale në terren, duke bërë çdo inspektim të gjurmueshëm dhe rezultatet e konstatimeve të

patjetërsueshme, duke eliminuar kështu përfundimisht procesverbale apo akte konstatimi ne letra dhe aspak transparente.

Në kuadër të këtij projekti janë trajnuar 260 inspektorë shtetërorë sanitarë, të punës, të mjedisit dhe të Zyrës së të Drejtave të Autorit, të cilëve do tu vihen ne dispozicion për punën e tyre këto pajisje.

Është e rëndësishme për t'u theksuar një risi e këtij projekti.

Është hera e parë që USAID ka përdorur sistemet e Shtetit Shqiptar të prokurimit dhe të financave, për kanalizimin e fondeve të SHBA-së për asistencë, në këtë rast pikërisht për Inspektoratin Qendror dhe ky është një vlerësim i madh për Qeverinë Shqiptare si dhe një akt i vërtete besimi i USAID ndaj Inspektoratit Qendror.

Për këto arsye, e nderuar Znj. Aleksander, duke Ju falënderuar Ju, USAID dhe popullin amerikan për financimin e këtij projekti, si dhe për vlerësimin dhe besimin që keni treguar në potencialet tona, kam kënaqësinë t'Ju kaloj fjalën.